



**UNIVERSITETI I GJAKOVËS
“FEHMI AGANI”**

Rr. ISMAIL QEMALI, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831

RAPORTI I BUXHETIT

01.01.2020-30.09.2020

Për: Këshillin Drejtues të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”

Nga: Zyra e Financave të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”

Lënda: **Raporti i shpenzimeve Janar – Shtator 2020**

Rr. ISMAIL QEMALI, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	3
1.1. Baza e përgatitjes së raportit	3
1.2. Politikat e kontabilitetit.....	3
1.3. Subjekti raportues	3
2. Kategoritë kryesore të buxhetit.....	8
2.1. Paga dhe Mëditje.....	8
2.2. Mallra dhe Shërbime.....	9
2.3. Shpenzimet komunale.....	11
2.4. Subvencionet dhe transferet	12
2.5. Investime Kapitale	12
3. Të hyrat vetanake.....	13
4. Konkluzion	13

Hyrje

1. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

1.1. Baza e përgatitjes së raportit

Raporti është përgatitur në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Nr. 03/L-048), Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit (Nr. 03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 46 dhe Ligjin (Nr. 04/L-116) për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit (Nr. 03/L-048) për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin (Nr. 03/1-221), dhe SNKSP e bazuar në para të gatshme – *Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme*.

1.2. Politikat e kontabilitetit

Baza e kontabilitetit dhe raportimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas LMFPP është baza e parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këtë raport paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizim të shpenzimeve, të cilat i kontrollojnë një institucion i vetëm – Thesari.

Të hyrat njihen atëherë kur janë nën kontroll të Qeverisë. Kjo përfshinë paratë të cilat janë transferuar në llogari të Thesarit në BQK, paratë që qëndrojnë në llogari nëpër banka komerciale në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e një organizate buxhetore në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato paguhet nga llogaria e vetme e Thesarit.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës.

1.3. Subjekti raportues

Raporti financiar paraqet aktivitetin financiar të Qeverisë së Kosovës ashtu siç është specifikuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (03/L-048) ku përfshihen të gjitha **organizatat buxhetore**, MASHT-i, si dhe nën-program i saj, **Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”**.

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” përbëhet prej tri njësive akademike:

1. Fakulteti i Edukimit
2. Fakulteti i Filologjisë dhe
3. Fakulteti i Mjekësisë

Fakultetet e Universitetit kanë këto programe: Fakulteti i Edukimit përfshin programin Parashkollor dhe Fillor, Fakulteti i Filologjisë përfshin programin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Fakulteti i Mjekësisë përfshinë programin Mami dhe Infermieri.

Të gjitha Fakultetet ofrojnë studime të rregullta të nivelit bachelor në përputhje me dispozitat e statutit të Universitetit.

Buxheti i UGJFA-së është i ndarë në mënyrë Institucionale, në të cilin përfshihen të gjitha njësitë akademike.

Në tabelën nr. 1 është paraqitur buxheti i vitit 2020 i lejuar në fillim të vitit fiskal.

Kategoritë Ekonomike	Buxheti i aprovuar për vitin 2020
Pagat dhe Mëditjet	1,184,828.00 €
Mallra dhe Shërbime	316,339.00 €
Shpenzime Komunale	50,000.00 €
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	650,000.00 €
Totali	2,301,167.00 €

Në tabelën nr. 2 është i paraqitur buxheti me rishikim sipas kategorive ekonomike:


Kategoritë Ekonomike	Buxheti me rishikim për vitin 2020
Pagat dhe Mëditjet	1,184,828.00 €
Mallra dhe Shërbime	256,339.00 €
Shpenzime Komunale	30,859.42 €
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	343,850.00 €
Totali	1,915,876.42 €

Në tabelën nr. 3 është i paraqitur buxheti dhe shpenzimet deri më 30.09.2020 si dhe struktura e shpenzimeve në raport me buxhetin e aprovuar:

Kategoritë Ekonomike	Buxheti i alokuar deri më 30.09.2020	Shpenzimet deri më 30.09.2020	Pjesëmarrja në % e shpenzimeve në raport me buxhetin e alokuar
Paga dhe Mëditje	898,844.66 €	898,844.66 €	100.00 %
Mallra dhe Shërbime	256,339.00 €	164,693.13 €	64.24 %
Shpenzime Komunale	30,859.42 €	14,934.56 €	48.39 %
Subvencione dhe Transfere	100,000.00 €	11,255.33 €	11.25 %
Pasuritë jo financiare(Kapitale)	343,850.00 €	34,959.22 €	10.16 %
Totali	1,629,893.08 €	1,124,686.90 €	69.00 %

Tabela nr. 3 Analiza e buxhetit

Paraqitja grafike e alokimit dhe e shpenzimeve të Buxhetit, për periudhën Janar – Shtator të vitit 2020:



Nga tabela e mësipërme shihet se në periudhën Janar - Shtator 2020, buxheti i UGJFA-së në raport me buxhetin e alokuar është shpenzuar në lartësinë prej 69.00 %.

Kategoritë :

- **Alokimi i pagave** – nga tabela nr. 3 shihet që buxheti për paga është shpenzuar 100 % në raport me buxhetin e alokuar. Kjo kategori, gjatë kësaj periudhe është shpenzuar sipas planifikimit të buxhetit dhe pjesa tjetër do të realizohet deri në fund të vitit.
- **Mallrat dhe shërbimet:** te kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, shihet që mjetet e shpenzuara për këtë periudhë janë 64.24 %, në raport me ato të alokuara.
Përmes kësaj, UGJFA-ja nga kjo kategori paguan shpenzimet fikse dhe ato variabile si p.sh. preparatet për dezinfektimin e objekteve, furnizim me libra, kontratat për sigurimin fizik, pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, mirëmbajtja e sistemeve elektronike, karburante për veturat zyrtare, shërbimet e kontraktuara, avanset për udhëtime zyrtare, furnizim me lëndë djegëse për ngrohje, furnizim me inventar etj.
- **Shpenzimet komunale** për periudhën Janar – Shtator 2020 janë shpenzuar në masë prej 48.39 % në raport me buxhetin e alokuar sipas planit të Rrjedhës së Parasë të vitit 2020. Këtu hyjnë të gjitha pagesat si: pagesa e energjisë elektrike, pagesa e ujësjellësit, pagesa për mbeturina, pagesat për ngrohje qendrore dhe pagesa për telefoninë fikse.
- **Subvencionet dhe Transferet**, mjetet e shpenzuara nga kjo kategori janë 11.25% në krahasim me mjetet e alokuara. Nga kjo kategori, në periudhën Janar - Shtator 2020, janë realizuar pagesat për praktikantët, subvencionimi për botimin e disa librave të profesorëve të UGJFA-së, subvencionimi për çmimin “Din Mehmeti”, subvencionimi për bashkëfinancim në projektin për COVID 19 mbështetur nga AUF (The University Agency of La Francophonie). Këtu parashihen edhe pagesat për bursat e studentëve të cilat janë të planifikuara me fillimin e vitit akademik 2020-2021.
- **Alokimi i Investimeve kapitale**, kjo kategori në këtë periudhë është realizuar 10.16 % në krahasim me buxhetin e alokuar ku është realizuar blerja e pajisjeve speciale mjekësore për laboratorin e Fakultetit të Mjekësisë, ndarja e zyrave në objektin e Rektoratit, rregullimi i parkingut dhe i zareve në Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin e Filologjisë.

Ndërtimi i Kampusit Universitar pritet të fillojë këtyre ditëve meqë procedurat e prokurimit janë në fazën e përmbylljes. Pas kësaj procedure vazhdohet me fazën e punimeve ku parashihet që mjetet të paguhet me avancë, pra nëse të gjitha procedurat e Prokurimit shkojnë në rregull, kjo kategori do të realizohet në përqindje maksimale.

Në fazën e pagesës është edhe kontrata me operatorin ekonomik për dhomën e serverëve me të gjitha pajisjet përcjellëse të Teknologjisë Informativë, të cilat do të jenë në funksion të stafit dhe studentëve.

Për krijimin e kushteve cilësore të punës për stafin, por edhe për shërbime më cilësore për studentët e Fakultetit të Edukimit dhe Fakultetit të Filologjisë është planifikuar rregullimi i disa zyrave.

2. Kategoritë kryesore të buxhetit

2.1. Paga dhe Mëditje

Në kategorinë Paga dhe Mëditje, për periudhën Janar - Shtator 2020, janë shpenzuar gjithsejtë 898,844.66 € Këtu përfshihen pagesa neto e pagave, honorarëve, mbinormave, komisionet e diplomave, pagesa sipas vendimeve për punë shtesë, pagesa për kontributet pensionale 5%, pagesa e tatimit të ndalur në burim për të gjithë punonjësit e rregullt të UGJFA- së dhe stafi i angazhuar me kontratë të honorarëve. Vlen të theksojmë që në këtë kategori nuk përfshihen punonjësit me kontratë për shërbime të veçanta dhe të gjitha pagesat tjera për punonjës jashtë listës – sistemit qeveritar të pagesave (Payroll).

Përshkrimi	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020	Shtator 2020	Total
Neto pagat	81,877.64	82,424.27	82,333.70	95,610.51	94,845.38	90,530.47	81,128.71	69,360.3	70,499.83	748,729.68
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi	4,633.14	4,684.05	4,666.06	5,400.65	5,397.24	5,124.70	4,608.47	3,929.42	3994.07	42,437.80
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar	4,633.14	4,684.05	4,666.06	5,400.65	5,397.24	5,124.70	4,608.47	3,929.42	3994.07	42,437.80
Tatimi në të hyra personale	6,911.33	7,008.56	6,967.87	8,378.46	8,364.01	7,905.96	6,865.21	5,682.73	5773.45	63,857.88
Ndalesat nga OMK		320.00								320.00
Sindikata e punëtorëve	128.74	132.22	131.98	138.59	143.56	138.21	127.33	120.87	118.87	1,180.37
Totali	98,183.99	99,253.45	98,765.67	114,928.86	114,173.34	108,824.04	97,338.19	83,022.74	84,380.29	898,844.66

Tabela nr. 4 Kategoria Pagat dhe Mëditje

Çdo vit UGJFA-ia shfrytëzon një shumë prej 58,879.00 € nga të hyrat vetanake, të cilat janë të destinuara vetëm për kategorinë Paga dhe Mëditje. Gjithashtu nga viti i kaluar kanë mbetur pa u shpenzuar vlera e të hyrave prej 51,286.03, të cilat mund të shpenzohen për këtë kategori.

2.2 Mallra dhe Shërbime

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, për periudhën Janar – Shtator 2020, janë shpenzuar gjithsejtë 164,693.13€- 64.24 %

Aktivitetet:

- Për shkak të situatës së krijuar të Pandemisë COVID 19, UGJFA vazhdimisht ka realizuar dezinfektimin e hapësirave të brendshme dhe është furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me preparate për dezinfektim dhe masa të tjera mbrojtëse.
- Gjatë muajit Shtator 2020 është zgjedhur operatori i ri ekonomik për shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të UGJFA-së.
- UGJFA ka kompletuar dhomën e serverëve me të gjitha pajisjet përcjellëse të Teknologjisë Informative, e cila se shpejti do të jetë në funksion të stafit dhe studentëve.
- Ndarja e zyrave të shërbimit me studentë në FE dhe FF, për krijimin e kushteve të punës me te përshtatshme për stafin dhe ofrimin e shërbimeve sa me cilësore për studentët.
- Furnizim me libra universitar për studentët e UGJFA-së.

Shpenzimet e projekteve ndërkombëtare do t'i paraqesim në tabelën nr. 5:

Kategoria e shpenzimit	Projekti DRIVE	Projekti SMAHPC	Projekti Research Cult	Projekti QUADIC	Totali I shpenzimeve
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit				40.00	40.00
Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar brenda vendit				1,440.00	1,440.00
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	360.00			540.00	900.00
Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit	480.00	3,120.00		1,080.00	4,680.00
Shërbime kontraktuese të tjera	3,630.02	11,193.98	1,301.88	1,030.00	17,155.88
Totali	4,470.02	14,313.98	1,301.88	4,130.00	24,215.88


2.3 Shpenzime komunale

Me buxhetin e vitit 2020 shpenzimet komunale janë realizuar në bazë të faturave dhe përbëjnë shpenzime që ndodhin çdo vit, thuajse në masën e njëjtë, pa ndryshime të mëdha. Prandaj, në vijim është paraqitur tabela me shpenzime për secilin operator ekonomik.

Kategoria e shpenzimit	Shpenzimet për periudhën Janar – Shtator 2020
PTK-Telefonia fikse	892.87 €
Shpenzimet e rrymës - KEDS	5,882.76 €
Shpenzimet e Ujit - Radoniqi	1,660.87 €
Ngrohtorja e Qytetit	5,735.34 €
Shpenzimet e Mbeturinave - Çabрати	892.87 €
Pagesa – vendim gjyqësore	0.00 €
Totali	14,934.56 €

Tabela nr. 6 Kategoria e Shpenzimeve Komunale

Paraqitja grafike e buxhetit të aprovuar dhe shpenzimeve për periudhën Janar - Shtator 2020 për Kategorinë Shpenzime Komunale:



2.4 Subvencione dhe transfere

Kjo kategori gjatë periudhës Janar – Shtator 2020 është shpenzuar në një vlerë prej 11,255.33€ Siç u tha më lartë, nga kjo kategori janë realizuar pagesat për praktikantët, subvencionimi për botimin e disa librave të profesorëve të UGJFA-së, subvencionimi për çmimin “Din Mehmeti”, subvencionimi për bashkëfinancim në projektin për COVID 19 mbështetur nga AUF (The University Agency of La Francophonie).

Në tremujorin e fundit është planifikuar të bëhet ndarja e bursave për studentët e dalluar të të gjitha njësive akademike të UGJFA-së.

2.5 Investime kapitale

Në periudhën Janar – Shtator 2020 nga kjo kategori është bërë blerja e pajisjeve speciale mjekësore për laboratorin e Fakultetit të Mjekësisë, ndarja e zyrave në objektin e Rektoratit, rregullimi i parkingut, i zyrave në Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin e Filologjisë, dhe disa renovime të cilat janë kryer në objektin e Rektoratit. Sa i përket ndërtimit të Kampusit Universitar, tenderi është në fazën e vlerësimit të ofertave dhe presim që në tremujorin e fundit të këtij viti do të fillojnë punimet me ç’rast do të realizohet e tërë shuma e mbetur e kësaj kategorie.

3 Të Hyrat

Të hyrat vetanake të UGJFA- së janë mjete financiare që grumbullohen duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës dhe Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovës. Këto të hyra grumbullohen nga pagesat e studentëve si: Pagesa e semestrit, pagesat e vërtetimeve, pagesat e regjistrimeve, certifikatës së notave, certifikatës së diplomave etj.

Shuma totale e të hyrave gjatë periudhës Janar - Shtator 2020 është **30,017.00 €**

Përshkrimi	Janar 2020	Shkurt 2020	Mars 2020	Prill 2020	Maj 2020	Qershor 2020	Korrik 2020	Gusht 2020	Shtator 2020	TOTAL
Të hyrat vetanake:	1,692.50 €	207.50 €	1,000.00 €	0.00 €	19,745.00€	4,339.50 €	916.00 €	22.5 €	2,094.00 €	30,017.00 €

4 Konkluzion

Performanca financiare e Universitetit të Gjakovës “FehmiAgani” gjatë kësaj periudhe Janar – Shtator 2020 është e mirë, kurse shpenzimi i buxhetit është bërë në masën prej 69.00 %. Përkundër vështirësive të krijuara për shkak të Pandemisë COVID 19, shpenzimet në përgjithësi kanë shkuar sipas planifikimeve dhe janë bërë në bashkëpunim me zyrën e prokurimit.

Nga: Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë dhe Zyra e Financave të UGJFA-s.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Mazlida Kumnova

